



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1369/2 prot.,

Datë 30.05.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SILA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur-marrëveshje kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara” me Nr. REF-45129-04-15-2025, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 12,687,900 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind), zhvilluar më datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, me Nipt. L81530012C
Adresa: Rruga dytësore, mbikalimi i Kasharit, objekt në zonën kadastrale 2105, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “SILA” SHPK me Nipt: K22518401P
Adresa: Fier Levan LEVAN Rruga Nacionale Levan-Vlorë, km 3, magazine 1 (nje) kateshe, zona kadastrale 2436, nr pasurie 414/20, vol 22, fq 95.

Nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me Nr. 1369/2025 Prot., datë 29.05.2025 e operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur-marrëveshje kuadër- me një operator

ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara” me Nr. REF-45129-04-15-2025, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 12,687,900 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind), zhvilluar më datë 02.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SILA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK me anë të ankesës me Nr. 1369/2025 Prot., datë 29.05.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “SILA” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “SILA” SHPK, të kriterëve si më poshtë: [...]

1. Shtojca 9; FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT/2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT; 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit
- b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të defekteve elektronike në mjete;
- d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- f) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit.
- g) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
- h) pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 3 (tre) ura ngritëse për mjetet objekt prokurimi
- i) pajisje për pastrimin nga brenda të motorrit me H2.
- j) pajisje për pastrimin e marmidave katalitike DPF.
- k) pajisje për kontrollin në presion të defektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;
- l) pajisje për kontrollin, riparimin & kalibrimin e turbinave të motorrit
- m) pajisje për kontrollin në presion të defektimit të sistemit të ftohjes;
- n) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- o) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- p) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

- q) pajisje per saldim me oksigjen & argon.& saldim elektrik
r) te kete repart te riparimit te karrocerise se automjetit (Shasise dhe perpunimit te llamarines) si dhe bojatisjes se mjetit te pajisur me: furre per lysterje, repartin per pergatitjen paraprake per bojatisje te kompletuar me pajisjet perkatese, si edhe pajisje per drejtim shasie te cilat te kene kapacitet ne pershtatje te plote per realizimin e sherbimeve te mjeteve.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2. 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

3. Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.05.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri